

SHOQATA SHQIPTARE PËR PSIKODRAMË

Shoqata Shqiptare per Psikodramë/Albanian Association for Psychodrama është themeluar me vendim gjykate 3150, ne date 21.09.2011, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, Shqipëri.

SHSHPP është një organizatë, e cila ka për qëllim:

1. Edukimin (trajnimi, formimi) për profesionin e psikoterapistit të psikodramës.
2. Rregullimin e legjislacionit për psikoterapinë si një profesion i pavarur në Shqipëri
3. Lobim dhe advokaci
4. Promovimin e psikodramës dhe psikoterapisë së grupit për publikun e gjerë dhe profesionistët e tjerë në fushat relevante.
5. Organizimin e aktiviteteve të nevojshme për zhvillimin e praktikës profesionale të psikodramës dhe psikoterapisë së grupit (si një profesion i pavarur)
6. Zhvillimin e aktiviteteve publikuese në fushën e psikoterapisë apo fushave dhe disiplinave të tjera të ngjajshme.
7. Zhvillimin e aktiviteteve kërkimore me qëllim kontribuimin në përmirësimin e psikodramës, psikoterapisë dhe shkencave të tjera psiko-sociale.
8. Aplikimin e psikodramës si një terapi për rritje personale ose vështirësi psiko-sociale në popullatën e gjerë.
9. Promovimin e aplikimit të psikodramës dhe psikoterapisë së grupit në edukim, shërbime sociale, këshillim, menaxhim konflikti, shërbime të shëndetit mendor dhe terapive dhe trajtimeve psikosociale për grupet vulnerabël në shoqëri.
10. Bashkëpunimin me organizata dhe insitucione, kombëtare dhe ndërkombëtare, qeveritare ose joqeveritare relevante.
11. Promovimin e dialogut dhe menaxhimit të konfliktit ndërmjet grupeve të ndryshme sociale përmes përdorimit të metodologjisë së psikodramës dhe psikoterapisë së grupit.

Shërbimet e ofruara

Të gjithë anëtarët e SHSHPP janë duke ushtruar praktikën psikoterapeutike përmes séancave në grup dhe individuale.

Grupi i parë psikoterapeutik filloi në 2013 dhe zgjati për 8 muaj.

Grupi i dytë psikoterapeutik filloi në prill 2014, po vazhdon rregullisht dhe është i hapur për të pritur anëtarë të rinj.

Nje grup i tretë terapeutik ka nisur rrishtas dhe është i hapur për pacientë që vuajnë nga çrregullime të rënda mendore.

Së shpejti do të ketë edhe një grup terapeutik/mbështetës i orientuar drejt mbështetjes emocionale dhe menaxhimit të stresit për familjarë dhe prindër të personave me aftësi të kufizuara ose çrregullime mendore.

Për studentët aplikohen tarifa shërbimi të reduktuara.

Për informacione të mëtejshme dhe aplikim, na kontaktoni në:

e-mail: psikodramashqip@gmail.com ose kontakto terapistin/en në adresën e ti/saj personale.